VENDIM
Nr. 705, datë 18.11.2021

PËR MIRATIMIN E GARANCISË SHTETËRORE NË FAVOR TË BANKËS AMERIKANE TË INVESTIMEVE SHA, PËR KONTRATËN E KREDISË NDËRMJET BANKËS AMERIKANE TË INVESTIMEVE SHA E FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL SHA, DHE OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE) GROUP SHA, PËR FINANCIMIN E KAPITALIT PUNUES, NË KUADËR TË NEVOJAVE PËR IMPORT TË ENERGJISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 3 e 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e garancisë shtetërore në favor të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., për kontratën e kredisë ndërmjet Bankës Amerikane të Investimeve sh.a. e Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a., dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Group sh.a., për financimin e kapitalit punues, në kuadër të nevojave për import të energjisë, në shumën 10 000 000 (dhjetë milionë) euro.
2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe OSHEE Group sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama